



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE KONTROLLUESE  
NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT PËR  
MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN ✓

Nr. 674 Prot.

Tiranë, më 16/1 2015

**UDHËZIM**

**“PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIMI NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 06.02.2012  
“PËR PROCEDURAT STANDARDE TË ZBATIMIT TË BUXHETIT”**

Nr. 3, Datë 16/1 2015

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 gërma “ç” dhe nenit 16 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në kushtet e një parashikimi financiar ditor me mungesë likuiditeti në llogarinë e unifikuar të Thesarit, Ministri i Financave,

**UDHËZON:**

**Në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:**

1. Pas fjalisë së parë të gërmës “h” të pikës 139, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

Në rast se konstatohet problem teknik në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) lidhur me procesin e ekzekutimit të pagesës së shpenzimit respektiv, kërkesa për pagesë nga dega e thesarit drejtuar Ministrit të Financave duhet të shoqërohet me një procesverbal të nënshkruar nga strukturat e thesarit në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit, ku argumentohet problemi teknik, i cili përmban referencat e faturës, të pagesës së dështuar si dhe printimet e transaksioneve respektive nga SIFQ.

2. Paragrafi i fundit i pikës 139, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në kushtet e mungesës së likuiditetit, kur nuk mund të zbatohet radha për asnjë nga prioritetet e pagesave të përcaktuara në pikën 139 të këtij udhëzimi, mund të urdhërohet pagesa pa radhë vetëm nëse:

- a. Ka një Vendim të Këshillit të Ministrave për përballimin e situatave emergjente apo katastrofave natyrore në rastet e pagesës së punëve, mallrave dhe shërbimeve, të shkaktuara prej tyre, ose që konsiderohen prioritet kombëtar.
- b. Ka një urdhër me shkrim të Ministrit të Financave, i dalë kundrejt një kërkesë të njësive të qeverisjes së përgjithshme, për pagesa nga llogaria e qeverisë, të cilat lidhen me ndjeshmëri sociale publike për shtresa të caktuara në nevojë ose në rastet kur Ministri i Financave, gjen të arsyetuar në kërkesën e njësisë, argumente konkrete që justifikojnë shkeljen e radhës së pagesave.

Në rastin e parashikuar në gërmën "b" të paragrafit të mësipërm, njësia e qeverisjes së përgjithshme i paraqet nëpunësit të parë autorizues një kërkesë me shkrim, duke argumentuar kryerjen me prioritet të pagesës së kërkuar.

Nëpunësi i parë autorizues, pasi e shqyrton kërkesën, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për shërbimet financiare, i propozon Ministrit të Financave pranimin ose jo të kërkesës, duke argumentuar nëse kërkesa përmban ose jo arsye të mjaftueshme për t'u trajtuar si prioritet.

Ministri i Financave, bazuar në kërkesën e njësisë së qeverisjes së përgjithshme, si dhe në propozimin e nëpunësit të parë autorizues, merr vendim me shkrim për urdhërimin ose jo të pagesës jashtë radhe.

Në vijim nëpunësi i parë autorizues, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për shërbimet financiare, sigurojnë zbatimin e urdhrit të sipërcituar. Nëpunësi i parë autorizues njofton çdo javë Ministrin për listën e pagesave të kryera jashtë radhe.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SHKËLQIM CANI**



**MINISTËR**